FORMULARI TIP I

Datë: 29/08/2017.

NJOFTIMI PËR INFORMIM NGA KËRKUESI PRANË AGJENCISË KOMBËTARE TË MJEDISIT/ AGJENCISË RAJONALE TË MJEDISIT DHE NJQV KU DO TË KETË VENDODHJEN INSTALIMI PËR APLIKIM PËR PROÇEDURË TË THELLUAR TË VNM-së

Bazuar në Ligjin Nr.10 431, datë 09.06.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", Ligjin Nr.12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", VKM-së Nr. 247 datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore, njoftimi duhet të përmbajë këto të dhëna:

1. Të dhënat e ekstraktit të QKR-së; Subjekti: BUNA-MAT sh.p.K. NIPT-i: K78619901B.
2. Adresën e vendodhjes së instalimit; Pjesa veriore e formacioneve gjeologjike të gropës së Burrelit, 10 km në veri të qytetit, Kodra e Bathrave, Derjan, Mat.
3. Titulli I instalimit; Karrierë kuarci
4. Një përmbledhje joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis me CD;
5. Konsultimet ndërkufitare, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi;
6. Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit. **info@akm.gov.al**

Mbaj përgjegjësi për dorëzimin e njoftimit pranë NJQV-së përkatëse në 20 CD/DVD

Kërkuesi/Përfaqësuesi i shoqërisë
(Meschit Buna)

Nr. kontakti
0697487976.

BUNA - MAT SHPK
K 78619901 B
BURREL

PERMBLEDHJE JO-TEKNIKE PER AKTIVITETIN "Karriere kuarci"





Subjekti: BUNA-MAT Sh.p.k

Vendndodhja: Pjesa veriore e formacioneve gjeologjike te gropes se Burrelit, 10 km ne veri te qytetit, Kodra e Batrave, Derjan, Mat.

Administrator: Mexhit Buna

BUNA - MAT SHPK
K 78619901B
BURREL

Permbajtja

1. Hyrje

1.1 Te pergjithshme

1.2 Procesi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

1.3 Kërkesat e përgjithshme për vlerësimin e ndikimit në mjedis të një projekti

2. Pershkrimi i kuadrit ligjor dhe institucional

3. Pershkrim i mjedisit te rajonit

3.1 Te pergjithshme

3.2 Pershkrimi i territorit te projektit te propozuar

3.3 Shtrirja gjeografike

3.4 Relievi dhe tokat

3.5 Klima

3.6 Flora dhe fauna

4. Pershkrimi i aktivitetit

4.1 Te dhena per projektin

4.2 Elementet e karrieres

4.3 Percaktimi i lartesise se shkalles

4.4 Program pune per ndertimin dhe shfrytezimin

4.5 Punimet e shpim-plasjes ne prodhim dhe zbulim

5. Identifikimi i ndikimeve ne mjedis lidhur me aktivitetin

5.1 Ndikimet negative ne mjedis

5.2 Ndikimet ne populsi

5.3 Ndikime e dukshme te projektit ne zonat rrethuese dhe peisazh

5.4 Nivelet dhe ndikimet e zhurmave nga projekti zhvillues

5.5 Ndikimet e projektit ne zhvillimin e rrugeve lokale dhe te transportit

5.6 Ndikimet ne flore dhe faune

5.7 Ndikimet fizike te projektit ne ndryshimet e topografise lokale dhe te erozionit te tokes.

5.8 Ndikime ne karakteristikat e tjera hidrografike

5.9 Ndikimet ne ekonomi

5.10 Shkarkimet ne ajer

5.11 Depozitimet ne toke dhe rrethinat

1.HYRJE

1.1 Te pergjithshme

Subjekti **"BUNA-MAT" SH.P.K** eshte rregjistruar prane QKB-se me numer NIPT-ti **K78619901B.** Vendi i ushtrimit te aktivitetit eshte ne Pjesen veriore te formacioneve gjeologjike te gropes se Burrelit, 10 km ne veri te qytetit, Kodra e Batrave, Derjan, Mat.

Subjekti **" BUNA-MAT " sh.p.k** me vendndodhje te selise ne **Diber, Burrel, Lagjia e Re, Nr 113** ushtron aktivitetin e tij per nxjerrje dhe shfrytezim te mineralit te kuarcit.

Vendburimi i kuarciteve Kodra e Batrave, Derjan, Mat, shtrihet rreth 10 km ne veri te qytetit te Burrelit. Ky projekt (karriere kuarci) bën pjesë në hartën topografike me shkallë 1:25000, me nomeklaturë K-34-89-A-a (Burreli). Kuota më e ulët e vendburimit është + 1560 m duke u rritur deri në kuotën më të lartë + 1710 m, me një kënd renie te përgjithshme nga 70-72^0.

Përmes projektit të propozuar **investitori BUNA-MAT Sh.p.k** synon te nxjerre dhe te shfrytezoje rezerva te konsiderueshme te mineralit te kuarcit. Karriera do te shtrihet ne nje siperfaqe prej 24 ha.

Sipërfaqja e objektit është 0.24 km2 ose 24 ha. Brenda kësaj sipërfaqe do të vazhdojë hapja dhe shfrytëzimi i karierës. Sipërfaqja e kufizuar nga tabela e koordinatave është vend-burimi i mineralit të kuarcit. Nga analizat dhe nga puna që është bërë në këtë vend burim ka rezultuar se aty shkëmbinjtë janë të përbërë nga elementi SiO2, kuarc, i cili shkon deri 98.81% prandaj është klasifikuar dhe emërtuar vend burim kuarci. Elementët e tjerë përbërës janë Al2O3 deri 0.60%; Fe2O3 deri 0.07%; Na2O=0.05%; K2O=0.15%. Përsa i përket përdorimit të këtij vendburimi, ai do të shfrytëzohet për nxjerrjen e kuarcit dhe pasi të kenë përfunduar të gjitha rezervat, do të rehabilitohet duke mbjellë fidanë pemësh. Nga llogaritjet e rezervave,per prodhimin vjetor te kuarcit parashikohen se do të duhen rreth 12 vite që të nxirren të gjitha rezervat e kuarcit që ndodhen në këtë vendburim.

Nga pikëpamja administrative është ne juridiksionin e Qytetit te Burrelit dhe ndodhet brenda kufinjeve administrative të komunës Derjan, rrethi Mat. Zona e lejuar minerare e dhënë për shfrytëzimin e mineralit kuarc, zë një sipërfaqe 0.24 km2 dhe kufizohet me koordinatat si më poshtë:

Nr.pikes	Koordinatat e pikave	
	Y	X
1	44 21 300	46 13 660
2	44 21 500	46 13 950
3	44 22 150	46 13 480
4	44 21 800	46 13 200

Aktiviteti merr ne konsiderate masat e nevojshme per te siguruar qe menaxhimi i tyre te kryhet pa demtuar shendetin e njeriut dhe pa i sjell deme mjedisit vecanerisht:

- Pa krijuar rreziqe per ujin, ajrin, token, floren ose faunen
- Pa shkaktuar pengesa nga zhurmat
- Pa demtuar peisazhin

Nje synim tjeter eshte te percaktoje e rekomandoje masat teknike organizative per zbutjen e ndikimeve negative qe mund te krijohen gjate zhvillimit te aktivitetit. Në kete aktivitet te subjektit **"BUNA-MAT" SH.P.K** do te punonesohen njerez te profesioneve te ndryshme si teknolog, manovrator, inxhiniere, punetore te thjshte e germuese etj. Për të krijuar një ambient pune optimal dhe mbrojtjen nga aksidentet, subjekti **"BUNA-MAT" SH.P.K** ka pajisur të gjithë punonjësit që punojnë në kete karriere me uniformë, kapele mbrojtese dhe me mjete mbrojtëse te nevojshme gjate kryerjes se proceseve te punes.

1.2 Procesi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Studimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) siguron një përmbledhje të të dhënave ekzistuese dhe informacion mbi kushtet e zhvillimit te aktivitetit. Në procesin studimor të VNM përdoret informacioni dhe të dhënat teknike ekzistuese lidhur me projektin ne studim.

Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis ka per qellim te siguroje nje nivel te larte te mbrojtjes se mjedisitpermes parandalimit, minimizimit dhe kompesimit te demeve ne mjedis, nga projekte te propozuara qe perpara miratimit te tyre per zhvillim.

VNM-ja zbatohet per projektet e propozuara, private apo publike, te cilat mund te shkaktojne ndikime te rendesishme negative, te drejtperdrejta ose jo ne mjedis, si pasoje e madhesise, natyres apo vendndodhjes se tyre.

Vleresimi i ndikimit ne mjedis hartohet qe ne fazen e projekt-idese per zhvillimin e aktivitetit, por gjithsesi, edhe per aktivitete ekzistuese te cilat jane objekt i nje leje mjedisore ose i ligjit per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis. Sipas kushtetutes se Republikes se Shqiperise, shteti siguron me te gjitha mjetet dhe mundesite qe ka, nje mjedis te paster dhe te sigurte per qytetaret dhe brezat e ardhshem.

1.3 Kërkesat e përgjithshme për vlerësimin e ndikimit në mjedis të një projekti

1. Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta mjedisore të zbatimit apo moszbatimit të projektit.

2. Ndikimet mjedisore të projektit vlerësohen në lidhje me gjendjen e mjedisit në territorin e prekur në kohën e paraqitjes së raportit përkatës për vlerësimin e ndikimit në mjedis të projektit.

3. Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përgatitjen, zbatimin, funksionimin dhe mbylljen e tij, sipas rastit, edhe pasojat e mbylljes së veprimtarisë, dhe dekontaminimin/pastrimin apo rikthimin e zonës në gjendjen e mëparshme, nëse një detyrim i tillë parashikohet me ligj. Vlerësimi përfshin, sipas rastit, si funksionimin normal, ashtu edhe mundësinë për aksidente.

4. Vlerësimi i projektit përfshin, gjithashtu, propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve të tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjatë zbatimit të projektit, përfshirë edhe vlerësimin e efekteve të pritshme të masave të propozuara.

Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis", i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse nga autoriteti përgjegjës për zhvillimin ose jo të projektit.

Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

a) procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;

b) procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Dokumenti bazë ku mbështetet procesi i VNM-së, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit, mund të jetë:

a) raporti paraprak i VNM-së për projektet e shtojcës II;

b) raporti i thelluar i VNM-së për projektet e shtojcës I.

Ne kete rast, subjekti i nenshtrohet procedurave per klasifikim per VNM te Thelluar ne baze te Ligjit 10440, date 07.07.2011 " Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis", **pika 19: Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë.**

2. PERSHKRIM I KUADRIT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

- *Ligji Nr.10 431,date 09.06.2011* ***' Per Mbrojtjen e Mjedisit '***
- *Ligji Nr16/2014* ***"Per mbrojtjen e cilesise se ajrit ne mjedis"***
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011* ***' Per Lejet e Mjedisit'***
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007* ***'Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes'.***
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007* ***"Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara"***
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003* ***"Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta"***
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011* ***"Per menaxhimin e integruar te mbetjeve"***
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003* ***'Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore'***
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009* ***'Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis'***
- *VKM nr.419 date 25.6.2014* ***'Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja.'***
- *Udhezim per dokumentacionin e duhur per* ***"Leje Mjedisore"***
- *Urdhëri Nr. 321 datë 11.2.2014* ***"Për Lejet Mjedisore"***
- *Udhëzim i MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014* ***"Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së'***
- *VKM nr. 686 datë 29.7.2015,* ***"Për miratimin e rregullave të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore".***
- *Ligji 12.2015 date 26.02.2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 440 datë 7.7.2011* ***Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis".***
- *VKM nr.247 date 30.04.2014* ***" Per percaktimin e rregullave, te kerkesave e te procedurave per informimin dhe perfshirjen e publikut ne vendimmarrjen mjedisore"***

3. PERSHKRIM I MJEDISIT TE RAJONIT

3.1 Te pergjithshme

Objekti ku zhvillon aktivitetin subjekti "BUNA-MAT" sh.p.k pozicionohet ne Pjesen veriore te formacioneve gjeologjike te gropes se Burrelit, 10 km ne veri te qytetit, Kodra e Batrave, Derjan, Mat.

Harte satelitore e zones ne studim

Harta topografike me kufijte e zones ne studim



Koordinatat e pikave kufizuese te zones se kerkuar

Pika	Koordinatat	
	Y	X
1	44 21 300	46 13 660
2	44 21 500	46 13 950
3	44 22 150	46 15 480
4	44 21 800	46 13 200

Keto koordinata jane percaktuar ne baze te **Lejes se Shfrytezimit Nr.1328, date 17/03/2009** qe subjekti disponon.

Fotografi te zones

3.2 Pershkrimi i territorit te projektit te propozuar

Krahina e Matit ku ben pjese komuna Derjan ku do te ndertohet ky projekt, është një muze i vërtetë arkeologjik dhe djep i lashtë i kulturës ilire. Aty janë zbuluar objekte prej ku dhe dalin të dhëna për të gjithë periudhat historike të zhvillimit kulturor jo vetëm të trevës së Matit por edhe më gjërë, Mati është bërë tani i njohur jo vetëm brënda vëndit por edhe jashtë Shqipërisë, si një krahinë arkeologjike e rëndësishme me vlera të veçanta, sidomos për gjurmimin e studimin e kulturës ilire". Në vitin 1952 në fshatin Bushkash nisën studimet e tre kodër varreve ilire ose siç quhen në gjuhën arkelologjike tumave. Në vitin 1952-1960 u zbuluan dhe u gërmuan edhe 35 tuma të tjerë ilire ku pjesa më e madhe e tyre i përket periudhës së parë të hekurit Në vitin 1971-1984 u zbuluan e u gërmuan dhe 18 tuma të tjera duke çuar numrin e tumave në 53. Kultura e tumave e varreve në Mat përfshin periudhat e bronxit të mesëm e deri në shekujt e parë të erës sonë. Përveç studimeve të kodër-varreve janë studiuar dhe disa vendbanime shpellore që ndodhen në veri të fshatit Bruç si dhe vendbanimi shpellor i Blazit, Këputës, Pëllumbave dhe Nezirit. Gërmimet e ndryshme arkeologjike kanë zbuluar gjurmë material që nga periudha e paleolitit të mesëm, në neolit e më pas. Ato hedhin dritë mbi ritet , doket e ilirëve, e arbërve, nivelin e zhvillimit ekonomik e kulturor që shprehet në vendbanimet e tyre në kala në qyteza në mënyrën e ndërtimit të tuneleve, varreve, ritit të varrimit etj. Në tumat e Matit janë gjetur me shumicë objekte zbukurimi të cilat, në të shumtën e rasteve janë prej bronxi, por janë gjetur edhe objekte prej ari siç janë dy temthorë spiralike. Këto objekte janë fibula të permasave të ndryshme të njohura në Ballkanin jugor dhe në Iliri që nga fundi i epokës së bronxit si dhe fibula të tjera. Janë gjetur armë dhe vegla pune, shpata bronxi, thika, heshta prej hekuri, hanxharë i quajtur "Sica", përkrenarë ilire, pafta bronxi të shekullit VI-V p.e.r. Një grup të larmishëm përbëjnë stolitë e tjera si stringlat, vargonjte, paftat, sumbullat, varëset, byzylykët dhe rruaza prej bronxi si dhe objekte prej qelqi dhe qelibari. Stolitë janë përpuanuar nga mjeshtrat vëndas, pirustët, të cilët banonin në luginën e Matit, Mirditës, Pukës që kishin për zanat shkrirjen e përpunimit të metaleve.

3.3 Shtrirja gjeografike

Mati shtrihet në pjesën qëndrore të Shqipërisë. Siperfaqja e rrethit është 997 km katrorë. Dendësia e popullsisë është 69 banorë për km katrorë. Në qytet banojnë 17% e popullsisë ndërsa pjesa tjetër banon në fshat. Kufiri natyror i Matit fillon nga lindja me malin e Dejës, zbret në Qafë-Murrë pastaj ngjitet nëpër majat e maleve të Balgjajt, që rradhiten në drejtim të jugut, për të zbritur në Qafë të Buallit, pastaj me në jug kufizohet me malësinë e Martaneshit duke u ndarë nga rrethi i Dibrës dhe Bulqizës. Nga këtej kufiri vijon në Malin me Gropa për të zbritur në qafën e Murrizës, vazhdon më tej duke u ndarë me rrethin e Tiranës, zbret në Qafë-Shtame, për tu ngjitur ne drejtim të veriperendimit në vargmalet e Skënderbeut, ku kufiri ndahet me rrethin e Krujës, vazhdon me Qafën e Belegut dhe përfundon në grykën e Shkopetit, që ndan Matin me rrethin e Kurbinit. Ndërsa nga ana veriperendimore kufizohet me malet Kulmi i Dervenit, vazhdon nga ana e veriut me kodrat e Prosekut, ku terrenet janë më të hapura dhe më të kalueshme, pastaj kufiri mbyllet për tu ndarë me rrethin e Mirditës. Mati gjendet midis kordinatave gjeografike 41o e 26` dhe 41o e 47`, gjërësi veriore dhe 19o e 52` dhe 20o e14` gjërësi lindore Ulëz Shkopet është vendi ku janë krijuar kanionet më të thellë e më të rëndësishme në Shqipëri. Tipike për këto ngushtime është Gryka e Shkopetit(40 metra) disa metra e thellë e çarë nga lumi Mat para se të dalë në fushë.

3.4 Relievi dhe tokat

Rilievi ngrihet mbi nivelin e detit në lartësinë më të madhe 2246 metra qe është Maja e Dejës. Dallohen katër nivele tarracore, që përbëjnë gropën e Matit nga Klosi deri në Ulëz. Në njërën nga këto tarraca lumore është vendosur qyteti i Burrelit, ku po ndertohet edhe ky projekt ne studim, ne Kodren e Batrave, ne komunen Derjan. Tokat jane te pasura me bimesi te shumte shkurrore dhe me elemente minerale te shumte si kuac, magnez, krom. Nga bimesia permenden lloje te ndryshme shkurresh si dhe bimesh drunore.

3.5 Klima

Klima në luginën e Matit është afërsisht si mesatare e klimës e gjithë Shqipërisë, lidhet me brezin e klimës mesdhetare e cila karakterizohet nga vera e nxehtë dhe e thatë me shkëlqim të madh të diellit dhe nga dimri relativisht i butë në luginë dhe disi i ashpër në brezin malor. Temperatura mesatare vjetore ne Luginën e Matit është afro 14 gradë celsius në ditët më të nxehta të korrikut arrin 38 gradë. Muaji më i ngrohtë është korriku me temperaturë mesatare 24 gradë, ndërsa më i ftohti është janari me temperaturë mesatare +4 deri 0 gradë celsius. Ditët me diell zënë 88-90% të ditëve të vitit.

3.6 Flora dhe fauna

Pyjet zënë rreth 66% të sipërfaqes së përgjitheshme të qarkut, duke përbëre një potencial të rëndësishëm mjedisor dhe ekonomik. Në rrethin e Matit përfshihen tre zona fitoklimatike nga 4 që ka Shqipëria, dhe konkretisht: (i)- zonën e gështenjës (Castanetum); (ii) zonën e ahut (Fagetum); (iii) zona e hormoqit (Picetum); dhe (iv) zonën e kullotave alpine (Alpinetum) Në kuadrin e decentralizimit dhe rritjes së kompetencave të pushtetit vendor, rreth 60% e fondit pyjor ju janë dhënë në administrim njësive të qeverisjes vendore. Këto pyje përfshijnë teritore të cilat ato i kanë në administrim dhe që po mbështeten me investime nga projekti i pyjeve i Bankës Botërore, i cili ka si qëllim rimëkëmbjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të tyre. Relievi dhe klima e favorshme bëjnë që në këtë zonë të ndodhen të gjitha katet bimore të vendit tonë, duke filluar me shkurret mesdhetare deri në livadhet alpine. Në lartësinë deri në 800 m rriten disa lloje dushqesh si bunga, shparthi, qarri, etj., dhe mbi këtë lartësi takohet kryesisht ahu (Fagus silvatica), pisha e zezë (Pinus nigra), rrobulli (Pinus heldreichi), bredhi i bardhë (Abies alba), arneni (Pinus peuce), lajthia (Corilus coturna), mështekna (Betula pendula) etj, të cilat pas viteve 90, si rezultat i shfrytëzimit pa kriter kane pësuar dëme të shumta.

Bimët mjekësore Në rrethin e Matit, ne komunen Derjan vlerë të madhe për ekonominë e komunitetit kanë edhe shfrytëzimi i burimeve natyrore (bimëve mjekësore), të cilat kanë një përhapje të gjerë në shumë zona të këtij rajoni. Ndër këto bimë me vlera të mëdha mjekësore mund të përmendim: dëllinja e zezë (Juniperus nigra), dëllinja e kuqe (Juniperus ohycedrus), lulkuqja (Papaver rhoeas), sherebela, qershia e egër, trumza, trëndafili i egër (Rosa kanina), mullaga (Malva sulvestris), salepi (Orchis mascula), hithra (Urtica dioica), kamomili (Chamomilla recutita), blini, çaji i malit (Sideritis roeseri), murrizi (Crataegus monogyna), etj., të cilat mblidhen nga banorët e grumbullohen nga subjektet të licensuara të rrethit. Më pas dërgohen sipas destinacionit për eksport. Theksojmë se ky potencial burimesh natyrore ndikon ndjeshëm në rritjen e të ardhurave e mirëqenies të banorëve në zonat rurale, si dhe kanë ndikim në uljen e varfërisë dhe papunësisë. Në rrethin e Matit, duke qenë që kushtet e mjedisit si dhe pozicioni gjeografik janë të përshtatshëm për rritjen dhe zhvillimin e shumë llojeve me vlerë, duhet që të jetë në qendër të vëmendjes një përkujdesje ndaj rregullave dhe kritereve të vjeljes e grumbullimit të këtyre pasurive natyrore, me qëllim menaxhimin e qëndrueshem të tyre.

- **Fauna**

Larmia dhe pasuria që ka kjo zonë si në aspektin klimatik, atë të tokave, të florës etj., ka krijuar kushte shumë të favorshme për zhvillimin e një bote shtazore shumë të larmishme. Këtë gjë e dëshmon ekzistenca e shumë llojeve të veçanta sipas karakterit të habitatit. Bota shtazore është shtrirë në gjithë teritorin si në atë të shkurreve, të pyjeve të dushkut, të ahut, e në lartësinë e kullotave alpine dhe të pak habitateve ujore. Në habitatet e dushkut, habitat ky që në 20 vitet e fundit vërehet një rimëkëmbje dhe rigjenerim i plotë i tij, në të gjitha vlerat e biodiversitetit, ka gjetur kushte zhvillimi dhe jetese shumë lloje të kafshëve të egra si: lepuri, thëllënxa e malit, derri i egër, ujku, dhelpra, etj. Në habitatet e pyjeve të ahut dhe të pishës, që janë më të dëmtuara vitet e fundit dhe që vërehet një dëmtim i ekosistemeve dhe i faktorëve të biodiversitetit në tërësi, gjejmë një numër më të vogël të kafshëve të egra që jetojnë në këto zona si ariu, ujku, shqiponja, rrëqebulli, dhia e egër, kaprolli, etj. Në habitatet e ujrave të kthjellta dhe të ftohta të këtyre lumenjve takohet trofta e egër dhe disa lloje të tjera peshqish autokton që e bën këtë zonë të dallueshme nga zonat e tjera të vendit. E gjithë kjo, pasuri e botës shtazore dhe me vlera të veçanta ofron kushte për zhvillimin e turizmit malor, familjar, sportiv, ekologjik, çlodhës.

4.PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

4.1 Te dhena per projektin

Objekti ku zhvillon aktivitetin subjekti "BUNA-MAT" SH.P.K pozicionohet ne **pjesen veriore te formacioneve gjeologjike te gropes se Burrelit, 10 km ne veri te qytetit, Kodra e Batrave, Derjan, Mat.**

Për të dhënë një pasqyrë sa më reale dhe për tu përgjigjur kerkeses së subjektit privat dhe ne varesi te infrastruktures ekzistuese, pasi u be rikonjicioni i terrenit ne vend, eshte studiuar mundesia e vendosjes optimale e karrjeres ne nje pozicion te tille qe te marre parasysh faktoret e meposhtem:

- Marrja ne konsiderate e pjeses se vendburimit qe ka me pak vellim zbulimi.
- Te jete sa me afer qe te jete e mundur nga infrastruktura egzistuese, si rruge, energji e uje.
- Te mos jete zone pyjore per te shmangur demtimin e mjedisit.
- Te jete e vendosur ne menyre te tille qe te mos shkaktoje shqetesime per fshatin ku eshte e ndertuar,dhe te mos kete as probleme zhurmash apo pluhurash.

Vendosja e karrjeres ne pozicionin e paraqitur ne planimetrite perkatese eshte bere duke respektuar faktoret e mesiperm. Shtrirja e karrjeres do te jete nga profili 1-1 deri ne profilin 4-4 (kjo e paraqitur ne planimetrite e saj dhe harte).

Hapja e karrjeres do te filloje me hapjen e rruges si magjistral kryesor dhe degezimet per cdo shkalle ose dy shkalle (te gjykohet nga zbatuesi i projektit ne nje faze te mevonshme duke bere edhe leverdine perkatese ekonomike se cili variant ka shpenzime me pak). Pavaresisht sa me siper kjo vendosje e karrjeres, lejon mundesine qe subjekti shfrytezues i kuarcit te hape disa fronte per shfrytezim te njekohshem dhe per fazen fillestare me me pak shpenzime. Proceset kryesore të tëknologjisë së nxjerrjes kanë të bëjnë me rrezimin e minerali, ngarkimin e tij dhe transportoin e tij nga fronti i punës në destinacion.

Hapja e karrierës.

Sipas planimetrise kufijte e trupit mineral do te jene :
Ne veri-perendim izoipsi +1710m
Nga veri-lindja profile gjeologjik B-B
Nga juge-lindja profile 7-7 dhe
Nga juge-perendimi kufiri gjeologjik C-C

Shfrytezimi i rezervave ne krahun verior konsiderohet faza e pare e shfrytezimit me karrjere, ndersa faza e dyte do te perfshije shfrytezimin e rezervave te krahut jugor, rezervat pertej profilit 4-4.

Hapja e vendburimit eshte parashikuar me shkalle 10 m per shfrytezim dhe zbulim, me depoztim te sterilit ne krahun veri-lindor dhe ne ate juge-perendimor, jashte kontureve te karrjeres. Hyrjet e shkalleve, me perjashtim te horizonteve +1710 m dhe +1560m jane parashikuar me gjysem-transhe Horizonti + 1710 do te hape nje transhe te plote me gjatesi 112 m.. Vendi i vendosjes se objekteve siperfaqesore eshte larg karrieres. Transhete e nevojshme per te kaluar nga njera shkalle tek tjetra do te parashikohen me pjeresi rreth 8 % . Hyrja ne karrjere behet nga profile 1-1.

4.2 Elementet e karrieres

Duke pasur parasysh pozicionin gjeografik te karrieres, relievin dhe parametrat gjeometrike te shkalleve, karriera do te kete formen e nje anfiteatri me parametrat e meposhtem:

1. Thellesia e vertikale e karrieres ne anen e siperme te saj 100 m
2. Numuri i shkalleve 10
3. Gjeresia x Gjatesi mesatare e karrieres 200x450m
4. Kendi i shuarjes se shkalleve 72^0
5. Kendi i shpatit te shkalles 80 °
6. Lartesia e shkalles 10m
7. Siperfaqja e zones me karrieren 0.24 km2

4.3 Percaktimi i lartesise se shkalles

Percaktimi i lartesise se shkalles te punes ne karriere eshte bere duke patur parasysh faktoret e meposhtem:

- Kushtet tekniko-minerare te vendburimit
- Vetite te shkembinjve rrethues
- Mjetet e parashikuara per shpimin e birave dhe menyren e rrezimit
- Menyren e tarnsportit te brendshem te kuarcitit

Transporti i kuarcit nga shkallet e karrieres deri ne vendin e depozitimit ne kuoten rreth+1710 m ose direkt tek konsumatori, parashikohet ngarkim me fadrome me kapacitet kove 2-3 m3 dhe kamione 20 tonesh. Karriera ne gjendje perfundimtare do te perfaqesohet nga 10 shkalle nga 10 metra sejcila. Lartesia e nenshkalles, deri ne formimin e shkalles se plote 10 m, do te varet nga situata faktike dhe kushtet e terrenit.

4.4 Program pune për ndërtimin dhe shfrytëzimin

Ne zgjedhjen e sistemit te shfrytezimit jane mare parasysh faktoret e meposhtem:

- Menyra e ngarkimit dhe transportit te sterilit
- Menyra e kryerjes se punimeve te zbulimit
- Menyra e ngarkimit dhe transportit te mineralit-gure gelqeror ne brendesi te karrieres dhe jashte saj

Ngarkimi i mineralit te kuarcit ne sheshet e shkalleve parashikohet te kryhet me eskavator ose me fadrome me kove 1-2 m3 , ndersa transporti ne brendesi te dhe jashte karrieres parashikohet te behet me fadrome (per distanca relativisht te vogla) dhe me automjete vetshkarkuese. Bazuar ne sa me siper sistemi i shfrytezimit qe parashikohet te perdoret eshte i thjeshte me transport te sterilit ne distance mesatare rreth 200-400 m, duke lejuar ne kete menyre depozitimin e sterilit ne aferi te karrieres, sipas vendeve te percaktuara ne projekt.

Elementet e sistemit te shfrytezimit

- Lartesia e shkalles se karrieres eshte 10m, me nenshkalle sipas nevojes rreth 5 m.
- Gjeresia e sheshit te punes 30-40 m
- Kendi i skarpates se shkalles 80^0

Radha dhe drejtimi i shfrytezimit

Shfrytezimi i ketij objekti do te behet me qiell te hapur me lartesi shkalle 10m dhe nenshkalle 5 m, per pjeset deri ne formimin e shkalles se plote.

Shfrytezimi do te filloje mbas mbritjes se magjistralit kryesor te rruges ne shkallet per te cilat subjekti mendon te filloje ne fazen e pare prodhimin e kuarcit me kosto sa me te ulet. Pas kryerjes se punimeve te mesiperme te hapjes se gjysem-transhe-se/ve te shkalles/ve perkatese, do te filloje zgjerimi i saj ne te dy drejtimet per te krijuar frontin e nevojshem per manovrimin e makinerive te shpimit, ngarkimit dhe transportit.

Shfrytezimi do te filloje nga lart poshte (nga shkallet me te siperme) dhe me alternativa ne dy ose tre grupe shkallesh per te manovruar per prodhimin dhe per efekt kostoje. Ne vartesi te kerkesave te konsumatoreve (tregut) per mineral kuarci, mund te punohet ne menyre paralele ne keto grupe shkallesh. Materiali i rrezuar do te zhvendoset neper sheshet e shkalleve ose ngarkohet me ekskavator ose fadrome ne automjet .

Vellimi i materialit steril per zbulim do te transportohet me automjet jashte teritorit te karrjeres, sipas vendeve te percaktuara ne projekt, por brenda zones se kerkuar per leje minerare. Ne baze te **Lejes se Shfrytezimit** qe subjekti disponon, me **Nr.1328, date 17.03.2009**:

Rezervat Gjeologjike te mineralit te kuarcit	**4000 ton**
Kapaciteti prodhues i karrieres	**1200 ton/vit**
Totali i investimeve	**6678000 leke**

4.5 Punimet e shpim-plasjes ne prodhim dhe zbulim

Per rrezimin shkembinjve parashikohet te perdoret lende plasese ne dy variante, me puse sondash dhe me dhoma minash. Rrezimi ne nenshkalle gjate krijimit te shkalleve te plota parashikohet te behet me bira te zakonshme minash.

Varianti me bira sondash

- Parashikimi i puneve te shpim plasjes eshte bere duke patur parasysh faktoret e meposhtem: Fortesia e shkembenjve rrethues eshte e tille qe ben te domozdoshem perdorimin e punimeve te shpim plasjes
- Ditet e punes ne vit 6 muaj x 4jave x 5 dp/jave=120 dp/vit
- Shpimi i birave do te behet kryesisht me sonde dhe ne raste te vecanta me cekic dore

- Ne rasten e rrezimit me dhoma minash-galeri sipas regullave te teknikes se sigurimit do te jene me permasa minimale 1.5x 1.2 m
- Shpimi i birave do te behet me sonde.
- Drejtimi i birave do te jete vertikal ose i pjerret

Gjate hartimit dhe zbatimit te pasaportes se punimeve te shpim-plasjes, te synohet qe coprat e nxjerra nga plasja do te jene me madhesi maksimum deri 300 mm.

Lartesia e shkalles 10 m

Distanca nga buza e skarpates deri tek rrjeshti i pare i puseve te shpimit.-4,2m

Vija e rezistences me te vogel llogaritet, 12 m

Distanca midis puseve 4,5 m

Konsumi i lendes plasese

Dinamit 0.1 kg/ton

ANFO 0.34 kg/ton

Konsumi i Lendeve Plasese dhe materialeve te tjera, duhet marre me 20% reserve.

Ne rastin e rrezimit te kuarcit ***me dhoma*** do te duhet te behet llogaritja dhe projektimi i punimeve te hapjes dhe rrezimit te masivit me projekt te vecante. Ne mbushjen e dhomave me lende plasese mund te perdoret si dhe ne sondat, pervec amonitit malor dhe perzjerje e nitratit te amonit me nafte ne raportin 94 kg nitrat amoni me 6 litra nafte, te pergatitur, duke zbatuar rregullat e teknikes se sigurimit per punet me lende plasese.

5.IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS LIDHUR ME AKTIVITETIN

5.1 Ndikimet negative ne mjedis

Per vleresimin e ndikimeve ne mjedis te projektit u ndoqen hapat e meposhtme:

- Njohja dhe studimi i projektit, teknologjia e tij, menyra e propozuar per ndertim, sasite,makinerite etj.
- Njohja me infrastrukturen ekzistuese
- Njohja me natyren e operacioneve te nevojshme ne mjedis, (germime ,ndertime, mbjellja e bimeve, sistemimi i lendeve te para te ndertimit.)
- Njohja me vlerat natyrore dhe mjedisore te zones dhe siperfaqes.
- Historiku i nderveprimit mjedisor me zonen.
- Konsultimi me shume dokumenta e raporte te VNM per veprimtari te njejte.
- Konsultimi me banoret e zones.

Me poshte paraqitet nje analize e emetimeve ne mjedis qe mund te vijne nga ushtrimi i ketij aktiviteti.Per vete natyren e veprimtarise impaktet negative jane te paperfillshme, subjekti i ka marre te gjitha masat per minimizimin e ndikimeve te mundshme negative ne komunitetin dhe mjedisin perreth si:largimi i mbetjeve te ngurta nga vete subjekti si dhe te mbetjeve nga germimet. Edhe zhurmat do te jene minimale pasi vendi ku zhvillohet aktiviteti eshte ne distance te pranueshme nga objektet e tjera te banimit ne kete zone.

5.2 Ndikimet ne popullsi

Zbatimi i pojektit të shfrytëzimit të kuarciteve nuk do të ndikojë në popullsi për pasojë nuk do të ketë ndikime pasuese mjedisore. Kjo shikohet dhe nga numri shumë i kufizuar i punonjësve vetëm 10. Aktiviteti për shfrytëzimin e kuarciteve nuk ndikon në infrastrukturën e ndërtuar nga njerëzit në vite për faktin që ky aktivitet do të ushtrohet në një zonë të virgjër përsa i përket ndërtimeve apo projekteve të tjera.

5.3 Ndikimet e dukshme te projektit ne zonat rrethuese dhe pejsazh

Gjate shfrytezimit te objektit parashikohet rigjenerimi hap pas- hapi i zones se shfrytezuar dhe kryerja e punimeve suplementare te mbushjes dhe sistemimit. Ne vendet e cakuar ne projekt parashikohet depozitimi i materialit te paperdorshem te mbuleses dhe perpunimi i tij me toka vegjetative per te mundesuar mbjelljen e bimeve dhe pemeve karakteristike te zones. Pamja e siperfaqes se objektit pas perfundimit te shfrytezimit te tij do te jete taracore, me e gjelberuar dhe me çlodhese per syrin. Punimet shtese, te parashikuar gjate shfrytezimit, do te mundesojne ruajtjen e te gjithe elementeve te ambientit dhe biodiversitetit, parandalimin e erozionit dhe gjelberimin e siperfaqes.

5.4 Nivelet dhe ndikimet e zhurmave nga projekti zhvillues.

Sic u permend dhe me siper ne karriere gjate punes normale te saj burime te zhurmes te njekoheshme mund te jene:

a) Puna e menjehereshme e eskavatorit, kompresorit dhe çekiçave shpues

b) Zhurma e kamionit te transportit , kompresorit dhe çekiçave shpues

Nivelet e zhurmave te krijuara per rastet a dhe b eshte i njejte. Ky nivel eshte pranuar i njejte, me supozimin qe makinerite e permendura me siper jane shume afer me njera-tjetren dhe zhurmat qe emetohen nga secila superpozohen mbi njera tjetren
Burimi kumuluar i zhurmave nga puna e njekoheshme e makinerive te permendura ne pikat a dhe b, ne distance 7 m nga to, eshte 220 dB. Vleresohet se niveli akustik i zhurmes ne rrugen aty prane eshte me i ulet se ai i zhurmes se nje makine qe kalon ne te , praktikisht ai eshte 40-50 dB qe i pergjigjet kushteve te nje bisede me ze normal. Analiza e frekuences te zhurmes te emetuar nga keto makineri dhe pajisje tregon se ato ndodhen nen mesataren e frekuences 200-2000Hz , e cila eshte e pranueshme nga veshi i njeriut. Niveli akustik i zhurmave ne distance 500m , ne te cilen ndodhet përroi pritet te jete 4-6 dB qe i pergjigjet kufirit auditiv dhe ne kete menyre, nuk do te ndjehet nga gjallesat dhe habitatete e ndodhura rreth zones se zhvillimit te aktivitetit.

Nivelet e zhurmave ne varesi te stines, duke marre ne konsiderate dhe zbutjen e tyre nga bimesia ne siperfaqe pritet te jete dhe me i ulet .

5.5 Ndikimet e projektit ne zhvillimin e rrugeve lokale dhe te transportit

Për të arritur ne vendin e ndertimit te ketij projekti, rruga është e ndërtuar vetëm se kërkon mirmbajtje. Kjo zonë nuk bën pjesë në projektet e zhvillimit për faktin së është një zonë malore në të cilën tre mujat e dimrit bllokohet gjithcka nga sasia e madhe e rreshjeve të borës. Këtu do të hapet një pjesë e vogël rruge e cila shërben për hapjen e karierës, kjo rrugë do të jetë e gjatë 2 km dhe do të lidhë kuotën +1790m me kuotën +1890m. Materiali që do të dali nga seksioni i rrugës pjesërisht do të përdoret për shtrimin e saj dhe pjesa tjetër do të çohet në sheshin ku do të ndërtohen objektet sipërfaqsore të karierës.

5.6 Ndikimet ne flore dhe faune

Ne zonen e kerkuar per shfrytezim nuk ka bime ujore. Zona eshte ne terren kodrinor malor ne formacione te forta kuarcore dhe ne kushte te papershtatshme per bime ujore. Prandaj nga ky aktivitet nuk do te kete demtime te tyre dhe rrjedhimisht as masa mbrojtese per to. Sipërfaqja e kërkuar për të nxjerrë kuarcin nuk përfshin ndonjë bllok me drurë frutorë apo zonë të pyllëzuar por është një sipërfaqe e zhveshur gati 90 % ku në pjesën tjetër dominon bari i hollë dhe shumë rallë shkurret.. Ky habitat nuk ofron mundësi për një biodiversitet të larmishëm dhe aktualisht nuk mund të strehojë gjitarë të mëdhenj. Gjitarë të tillë si lepuri e dhelpra meqënëse kjo zonë është e zhveshur janë kalimtarë, ndërsa më të zakonshmit janë harabelat, trumcakët dhe zogjtë shtegtarë etj. Më të përhapur nga zvarranikët janë hardhucat dhe shumë pak gjarpërinjtë.

5.7 Ndikimet fizike te projektit ne ndryshimet e topografise lokale dhe erozionit te tokes.

Ne projekt eshte parashikuar nje radhe dhe drejtimi i tille i shfrytezimi, qe ne kombinim me masat e tjera suplementare te mbushjes, sistemimit dhe trajtimit, parandalojne erozionin, shembjen dhe vithisjen e shpateve te karrieres dhe siperfaqes se tokes rreth saj.

Formacionet shkembore qe perbejne objektin jane te forte e te qendueshem dhe parametrat gjeometrike te shkalleve te karrieres apo sheshpushimeve te tyre, jane zgjedhur ne menyre te tille qe te parandalojne fenomenet e ndryshme me efekte shkaterrues ose gerryes.

5.8 Ndikime ne karakteristikat e tjera hidrografike

Ushtrimi i ketij aktiviteti, ne kushte optimale dhe perfundimi i shfrytezimit te kuarcit ne kete objekt, nuk do te ndikoje ne nivelin e ujrave tokesore, ne rruget ujore, dhe ne rrjedhen e ujrave nentokesore. Ne zonene e shfrytezimit dhe perreth saj nuk ka burime ujore nentokesore dhe shpime te ndryshme te karakterit hidrogjeologjik

5.9 Ndikimet ne ekonomi

Persa i perket ndikimeve ekonomike ky aktivitet sjell ndikime pozitive ne ekonomi duke rritur te ardhurat jo vetem te investitorit, nepermjet nxjerrjes dhe shfrytezimit te mineralit te kuarcit, por edhe duke punesuar punonjes nga zona perreth; rrit keshtu nivelin e tyre te jetes.

5.10 Shkarkime ne ajer

Shfrytëzimi në karierë për të nxjerrë kuarc nuk shoqërohet me emetime kimike, për rrjedhojë nuk kemi të bëjmë me përqëndrime dhe ndikim të tyre në mjedis apo ne ajer. Në procesin teknologjik të nxjerrjes së kuarcit nuk do të përdoren lëndë të vecanta, kimikate me aroma sulmuese apo lloje të tjera lëndësh që janë të dëmshëm si për mjedisin ashtu dhe për njerëzit. Gjate ushtrimit te aktivitetit te shfrytezimit nuk ka emetime te ndryshme kimike, te çdo lloji qofshin ato.

5.11 Depozitimet ne toke dhe rrethinat

Aktiviteti parashikon vetem shfrytezimin e kuarcit dhe nuk leshon ne ambjent elemente kimik ose te tjere te demshem per mjedisin. Materiali qe do te depozitohet ne vendet e shfrytezimit eshte i paster dhe me tregues fizike, petrografik, kimik dhe granulometrike te njejte me ate te depozitimeve deluvionale te mbuleses se pakte te shkembinjve masive renjesore. Sterilet e dala gjate procesit te shfrytezimit te kuarcit depozitohen perkohesisht ne sheshe te vecanta dhe me pas perdoren per rigjenerim te karrieres.